



P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e Komitetit për Komunitete, e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **07.11.2023**, me fillim në orën **10.00**. Këtë mbledhje e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, **z. Bajram Morina**.

Kryesuesi: Fillimisht përshëndetje për të gjithë, faleminderit për praninë tuaj! Përshëndetje për Shefin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, z.Lendrit Qeli, përfaqësuesit të KFOR-it, OSBE-së, drejtorin e Shërbimeve Publike z. Përparim Krasniqi, përshëndetje për anëtarët dhe të gjithë të pranishmit. Ky është takimi i gjashtë për vitin 2023. Për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

R E N D I T E

1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë rreth procedurave të procesit të regjistrimit të popullsisë;
3. Informatë rreth gjendjes socio-ekonomike të komuniteteve jo shumicë;
4. Informatë nga ZKK-ja;
5. Të ndryshme.

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë vërejtje apo sugjerim rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë unanime procesverbali kalon.

2. Informatë rreth procedurave të procesit të regjistrimit të popullsisë.

Kryesuesi: Në cilësinë e anëtarit të komisionit për regjistrim të popullsisë i themeluar nga zyra e kryetarit të komunës, ku gjithsej jemi 9 anëtar të komisionit. Fillimisht është planifikuar të behet regjistrimi në majin shtator, pastaj në muajin shtator mirëpo siç po shihet do të shtyhet përsëri procesi i regjistrimit nëse nuk sigurohen materialet e nevojshme për këtë proces. Agjencia e Statistikave të Kosovës janë duke punuar për procesin e regjistrimit mirëpo sfida kryesore mbetet sigurimi i tabletave me ane të cilit do të bëhet ky regjistrim. Po ashtu sfida mbetet edhe regjistrimi i komunitetit serb. Në komunën e Rahovecit sipas raportit të fundit nevojiten 24 aplikime për regjistrues dhe 3 aplikime për mbikëqyrës(1 në për Hoçë të Madhe), pasi kemi probleme rreth aplikimit me aplikant për plotësuar kriteret që nevojiten për procesin e regjistrimit. Pra gjithsej nevojiten edhe 24 aplikime të reja në shume vende të komunës së Rahovecit për mbarëvajtjen e procesit të regjistrimit si me regjistrues e po ashtu edhe me mbikëqyrës. Si zyre për Komunitete dhe kthim, ju bëj thirrje të gjithë komuniteteve jo shumicë e sidomos të komunitetit serb që të aplikojnë për procesin e regjistrimit pasi është obligim moral dhe ligjor.

Faton Ramadani – Përshëndetje për të gjithë. E falënderoj shefin e ZKK-së për sjelljen e informatës dhe prezantimin e saj. Pyetje im është se a munden me bo ushtrimin e detyrës në procesin e regjistrimit edhe aplikonte që janë në marrëdhënie të punës, kur dihen problemet e mos aplikimit në procesin e regjistrimit.

Lendrit Qeli – Nga takimet që kemi pasur e posaçërisht një pyetje të tillë jam këtu përshtruar edhe kryeministrit në takimin që kisha, mirëpo nuk kemi pasur asnjë përgjigje rreth kësaj dhe nuk kemi mundësi e as të drejtë edhe të komentojmë rreth kësaj, mirëpo po besoj që një përgjigje të tillë mund ta marrim nga enti për statistika.

3. Informatë rreth gjendjes socio-ekonomike të komuniteteve jo shumicë.

Goneta Mustafa – Përshëndetje për te gjithë te pranishmit. Ne mungesë te pjesëmarrjes drejtoreshës se Shëndetësisë, atëherë jam e autorizuar që te përfaqësoj ne këtë mbledhje me të dhënat e nevojshme për te gjitha rastet sociale që i posedojmë si zyre. Pra familjet përfituese që përfitojnë janë gjithsej 551 raste, ku prej tyre janë 65 të komunitetit ashkalinjë, 1 komuniteti egjiptian, 1 komuniteti boshnjak, 3 komuniteti rom, 23 komuniteti serb, 457 shqiptar. Po ashtu me aftësi te kufizuara kemi 7 raste te komunitetit pakicë, ku janë 5 raste te fëmijëve te komunitetit serb dhe 2 raste te fëmijëve te komunitetit rom.

4. Informatë nga ZKK-ja-

Lendrit Qeli - Zyra për Komunitete dhe Kthim ka për fokus përmirësimin e gjendjes se komuniteteve jo shumicë ne komunën e Rahovecit, pastaj përmirësimin e infrastrukturës, zhvillimin e aktiviteteve kulturore, arsimore dhe edukative, fasilitim, integrimin dhe zhvillimin e pozitës se te kthyerve dhe riatdhesimi nga vendet e treta, pastaj fushata senzibilizuese për çështje jetike si arsimi, shëndetësia barazi gjinore dhe multikulturalizmi dhe bashkëjetesës ndëretnikë. Po ashtu si zyre jemi marr me aktivitete dhe fusha te ndryshme si arsimi, shëndetësia, siguria, pjesëmarrja ne aktivitete, trajnime dhe sfidat e komuniteteve rom ashkali dhe egjiptian ne punësimin ne sektorin publik. Pra si zyre për komunitete dhe kthim jemi angazhuar ne përmirësimin e cilësisë se arsimit për komunitetin rom ashkali dhe egjiptian dhe jemi ne kërkim te donatoreve për mbështetjen e nxënësve dhe studenteve te komunitetit jo shumicë, me synimin që ti ndihmojmë ne mundësimin e tyre për te ndjekur arsimin e lart, pastaj kemi pasur fushata senzibilizuese për regjistrimin me kohë te fëmijëve te komunitetit jo shumicë në klasë të parë, fushatë vetëdijesuese për vaksinimin e fëmijëve, pjesëmarrje ne takime te ndryshme ne rreth projekteve specifike rreth nevojave te këtyre komuniteteve si në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale dhe qasjen ne punësim strehim dhe banim dhe luftimin e diskriminimit. Po ashtu edhe vizita neper vendbanimet ku janë komunitetet jo shumicë posaçërisht neper lagje dhe shkollave mikse me përbërje te komuniteteve për tu njoftuar me kushtet, në identifikimin e nevojave specifike te tyre dhe ne zhvillimin e projekteve te përshtatshme e posaçërisht ne infrastrukturë dhe çështje tjera për mirëqenien e tyre.

Faton Ramadani – Përshëndetje për te gjithë. Unë kisha kërkuar që në seanca tjera të na dërgohen ne email informata si material që ka të bëj me pikën e rendit te ditës, që me pas mundesi me analizue me gjerësisht.

Merisa Sharku-Vuçitërna- Përshëndetje për te gjithë. Është mbledhja e parë që unë marr pjesë si anëtare e Komitetit për Komunitete dhe dëshiroj të jap kontributin si anëtare e këtij komiteti. Un kam një pyetje për zyrën për komunitete rreth investimeve kapitale pasi me herët u tha se buxheti është 20,000 dhe dua te di se çka përmban ky buxhet.

Lendrit Qeli – Kryesish ka të bëj me punë administrative pasi funksion si kod për investime në kuadër të zyrës se kryetarit.

Të ndryshme.


Dusan Stojanović – Përshëndetje për te gjithë. Pyetja ime ka të bëj me drejtorin e Shërbimeve Publike z. Përparim Krasniqi, rreth shenjës se komunikacionit e cila ndodhet ne kryqëzimin te vendi i quajtur te rrasat, e cila e parandalon kyqjen ne rrugën Bekim Isma, pasi që autobusi i cili vjen Mitrovica ne Rahovec nuk lejon kthimin ne atë rrugë.

Përparim Krasniqi – Te rasti i devijimit te rrugës Bekim Sylka dhe shenjës se vendosur ne baz te ligjeve te komunikacionit që e ndalon kyqjen ne atë rrugë, për shkak se ajo rrugë është e ngushtë dhe kjo është arsyeja e ndalimit të kalimit të mjeteve te renda në atë rrugë. Kështu që paraprakisht duhet bëni kërkesë pran drejtorisë se shërbimeve publike dhe me pastaj kërkesa juaj të shqyrtohet dhe me pas mundësi me i dhanë një zgjidhje rastit te tillë.


Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi diskutime tjera, e konsideroj të mbyllur këtë takim dhe shihemi ne mbledhje të tjera.

Mbledhja përfundoi: 10:40

Procesmbajtësi:


Agim Hoti

Kryesuesi i mbledhjes:


Bajram Morina

